



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.10406/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nehat Idrizi - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Lumni Sallauka, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: A.S. nga Gjilani, të cilin e përfaqëson F.A, avokat në Gjilan, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Komuna e Gjilanit - Drejtoria e Arsimit, e përfaqësuar nga Burim Maliqi, zyrtar ligjor në zyrën e avokatit të Komunës, për shkak të kompensimit të pagave jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1440/2020, të datës 04.10.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 16.06.2022, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Komuna e Gjilanit - Drejtoria e Arsimit, e përfaqësuar nga Burim Maliqi, zyrtar ligjor në zyrën e avokatit të Komunës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1440/2020, të datës 04.10.2021, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1440/2020, të datës 04.10.2021, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Aprovohet si e bazuar me ligj kërkesëpadia e paditësit A.S. nga Gjilani dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,334.00€ dhe atë në emër të kompensimeve të ushqimit për 667 ditë të pranisë në punë prej datës 18.04.2017 e deri me datë 18.06.2021, në emër të kompensimit për pagë jubilarë në shumën prej 229.50 €, të gjitha në shumë 1,563.50 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 14.04.2020 e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të obligohet e paditura Komuna e Gjilanit - Drejtoria e Arsimit, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 270€, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, sa i përket pikës I dhe II, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, për shkak të shkeljes thelbësore të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që duke e aprovuar ankesën e të paditurës, ta prishë aktgjykimin e atakuar, ta refuzojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e të paditurës si të pabazuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim/rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, me datë 14.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e pagave të shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, kundër të paditurës, të precizuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.10.2021, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit A.S. nga Gjilani, që për ditët e pranisë në punë t'i bëhet kompensimi për ushqim për 667 ditë të pranisë në punë në shumën prej 1,334.00 € për periudhën 18.04.2017 deri në përfundim të vitit shkollor 18.06.2021 si dhe kompensimi për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punës, 50% të pagës bazë dhe atë 229.50 €, me një shumë të përgjithshme prej 1,563.50 €, me kamatë ligjore prej datës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.1440/2020, i datës 04.10.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: kërkesëpadija e paditësit është e bazuar me ligj ashtu që gjykata ka vendosur që ta detyrojë të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,334.00 € dhe atë në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për 667 ditë të pranisë në punë prej datës 18.04.2017 e deri me datë 18.06.2021, në emër të kompensimit për pagë jubilarë në shumën prej 229.50 €, të gjitha në shumë 1,563.50 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 14.04.2020 e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor si dhe kjo çështje nuk ka të bëjë me parashkrim të kërkesave konform dispozitave ligjore.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragraf 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nenit 87 të Ligjit të Punës, nenit 17 të Ligjit për Gjykatat. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit 382 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, e po ashtu nuk është kontestuese se paditësja për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri më 18.06.2021, ka gjithsej 667 ditë pune, e për të cilën periudhë kërkon kompensim të shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”.

Me nenin 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Me nenin 35 paragraf 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: “Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti”.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9 “.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit ti paguaj pagën bazë për shpërblim jubilar dhe për ushqim, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës dhe se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës lidhur me atë se e paditura nuk ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e kësaj kontrate me ç ‘rast të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 përcaktohet se: “1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut ”, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: “ Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit bien të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë del të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar të drejtën materiale lidhur me afatshmërinë e padisë-gjegjësisht se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar, për shkak se, në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, me nr. 03/L-212 i dt. 01.11.2010, përcaktohet se: “ Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 - vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës ” duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe e cila ishte në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik, rrjedh se padia e paditëses është e lejuar dhe e ushtruar brenda afatit kohor.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 paragraf 1 dhe 2 i LMD-së, me nr. 04/L-077 i datës 30.05.2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoj edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të autorizuarit të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.10406/21, me datë 16.06.2022

Kryetari i kolegjit  
Nehat Idrizi, d.v